

Deklaratë për shtyp

Berat, më 5/6/2017

Drejtuar publikut të gjerë e institucioneve shtetërore!

Sot, më date 5 Qershor 2017- Ditën Botërore të Mjedisit, kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë publikisht se organizata "Për Mirëqënie Sociale dhe Mjedisore" Berat, ka nisur zbatimin e projektit të saj më të fundit: "Një sy për Mjedisin".

Ky projekt është grant i mbështetur nga programi SENIOR II- nga REC Shqipëri, e mbështetur financiarisht nga Qeveria Suedeze.

Nëpërmjet këtij projekti kjo organizatë në zbatim të projektit, si pjesë e Rrjetit të Vigjilencës, drejtuar nga Qendra EDEN,ka si synim të bashkërendojë punën e saj me institucionet përkatëse që mbështesim e monitorojnë punën për nxitjen e politikave dhe praktikave më të mira që sigurojnë efikasitetin e energjisë, diversifikimin e burimeve për energji të pastër dhe me kosto të përballueshme nga qytetarët e shtresat e varfra dhe të mesme në Berat e më gjerë.

Nëpërmjet tij organizata do të synojë:

- Njohjen e sfidave të performances së energjisë në banesa dhe të furnizimit me energji në qytetin e Beratit;
- Rritjen e njohjes së ligjit 116/2016 në nivel lokal, për të rritur efikasitetin e energjisë së përdorur.
- Forcimin e rolit përfshirës së shoqërisë civile në politikat e energjisë.
- Sensibilizim të popullatës e komunitetit mbi rëndësinë e energjisë së "pastër".

Ky projekt i nisur në Maj 2017, do të kalojë në disa faza që janë: Ngritja e grupit të punës në nivel Kombëtar e në lokalitetin tonë- Berat; Vlerësimin e performances së energjisë në banesa nëpërmjet konceptit të "Varfërisë së Energjisë"; Grumbullimin e vlerësimin e të dhënave që EDEN Center do të ndërtojë; Publikimin e të dhënave në një raport vlerësues; Lobim në nivel lokal e Qendror mbi çështjet e efikasitetit të energjisë;Ngritjen e këtyre çështjeve në programet politike të procesit zgjedhor 2017.

I gjithë aktiviteti vjen në ndihmë të qytetarëve, politikave mjedisore në qytetin tone dhe ndihmon edhe në rritjen e profilit të performances së punës së organizatës sonë mjedisore, e gjitha kjo në sinkron me organizatat e tjera ku rrjeti i Vigjilencës vepron, nën drejtimin e Qendrës EDEN, e mbështetjen e programit SENIOR II- REC Shqipëri, financuar nga Qeveria Suedeze.

Organizata: "PërMirëqënie Sociale dhe Mjedisore", Berat

Lagjja: "30 Vjetori", Rruga "Sotir Kolea"

Pallati nr.5, kati I, Berat

Tel: 00355 698488794

www.natyraberat.org

https://www.facebook.com/FSEW.BERAT/